



KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA

Nr. 186 prot.

Shkoder, më 24 Mars 2021

**Lënda:** Kërkesë për regjistrim të Vendimit nr. 304 (451), datë 23.05.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me objekt "Shfuqizimin e plotë të raport Kontrollit përfundimtar të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër" datë 13.12.2018.

**Z. Agron Hasanaj DREJTOR,  
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, SHKODËR**

I nderuar z. Hasanaj,

Ju informojmë se Shoqëria K. F. "Vllaznia" sh.a. me datë 17.05.2018 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Shkodër me kërkesë padinë me objekt "Shfuqizimin e plotë të raport Kontrollit përfundimtar të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër", dërguar me nr. 124/3 prot, datë 13.12.2018 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, ndaj njoftim vlerësimit për detyrime tatimore nr. 124/4 prot, datë 07.12.2017.

**Kjo Gjykatë me vendimin e saj nr. 304 (451), datë 23.05.2019 ka vendosur si më poshtë:**

- Nxjerrjen jashtë juriksionit gjyqësor të çështjes me nr. regj them 558/1363 (31154-00423-83-2018), datë 17.05.2018 me palë paditëse **Shoqëria K. F. "Vllaznia"** datë, me NIPT LI7029001S, me administrator Z. Astrit Gjyrezi .
- Kundër vendimit lejohet ankimi i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Për palët ndërgjyqëse, ky afat fillon nga dita e komunikimit të vendimit.

Sa më sipër **Shoqëria K. F. "Vllaznia" sh.a.** në respektim të këtij vendimi ka ushtruar ankimi për në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë me vendimin e saj nr. 00-2020-118, datë 15.06.2020 mbi ankimin e Shoqëria K. F. "Vllaznia" sh.a. ka disponuar si më poshtë:

- Prishjen e vendimit nr. 304 (451), datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate, me të njëjtin trup gjykues

Në të tilla kushte çështja është kthyer për rishqyrtim pranë Gjykatës së Shkallës së parë ,në respektim të vendimit të mësipërm.

Ky fakt rezulton nga :

1. Vendimi nr. 304 (451), datë 23.05.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me shënimin mbi vendimarrjen e Gjykatës së Lartë, bashkëngjitur kësaj kërkesë.
2. Vërtetimi nr.333 datë 24.03.2021, që çështja e mësipër përshkruar ndodhet për gjykim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, bashkëngjitur kësaj kërkesë.


Ky informacion i vihet në dispozicion Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, për chek-in në sistem dhe pezullimin e masave shtrënguese për detyrimet tatimore të KF Vllaznia” sh.a., me NIPT LI7029001S, detyrime të dala nga Njoftim Vlerësimi i bazuar në Raportin e Kontrollit Tatimor, objekt i ankesës dhe shyrimit në proces gjyqësor, për sa cituar më sipër.

Kërkesa bazohet në nenin 89, pika 2 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimi Nr.24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ju falemnderit për angazhimin tuaj,

Për Klubin e Futbollit “Vllaznia” Sh.A. me Vendim Delegimi

KRYETARE

  
Voltana Ademi





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 558/1363 (31154-00423-83-2018)  
Dt. Rregj. 17.05.2018

Nr. Vendimi 304(451)  
Dt. Vendimi 23.05.2019

V E N D I M

“ Per nxjerrjen e ceshtjes jasht juridikstonit gjyqësor”  
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Shkoder, e perbere nga:  
Valbona Durraj – Gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Borana LITI, sot me date 23.05.2019, ora 12.30, kryesisht, në evidentim të veprimeve pergatitore të çështjes administrative me nr.Rregj.Them. 558/1363 (31154-00423-83-2018) datë 17.05.2018, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS: Shoqeria K.F. “Vllaznia” sh.a., me nipt LI7029001S, me seli ne Stadiumi «Loro Boriqi», perfaqesuar nga Administratori z. Astrit Gjyzezi, i identifikuar me karte identiteti nr. personal G30923042L.

E PADITUR: Drejtora Rajonale Tatimore Shkoder  
me adrese: Rruga Studenti, ish-Godina e Qendres se Informatikes.

OBJEKTI: Shfuqizimin e plote te raport kontrollit perfundimtar te Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder derguar me nr. 124/3 prot., date 13.12.2018 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder ndaj Njostim Vleresimi per detyrimet tatimore nr 124/4 prot.,07.12.2017.

BAZA LIGJORE: Neni 32, 154, 156 i K.Proc. Civile  
Neni 7 shkronja “a”, neni 11 pika 1, neni 15 shkronja “a”, neni 17 pika 1 shkronja “a”, te ligjit nr. 49/2012, date 3.5.2012 “Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarreveshjeve administrative”.  
Kodi i Procedurave Administrative, nenet 107, 108, 109.  
Ligji nr.9920 dt 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar me Ligjin nr. 10148 dt.28.09.2009, Ligjin nr.10209, dt.23.12.2009, Ligjin nr.10261 dt.01.04.2010 (kreu XIII Ankimi Administrativ Tatimore), nenet 106, 107, 108, ndryshuar me udhezim te ministries se financave nr.24 dt. 02.09.2008, ndryshuar me udhezim te ministrise se financave nr.37. dt.01.09.2009, udhezimit nr. 6 dt. 19.02.2010,

udhëzimit nr. 13 dt. 14.04.2010.

Gjykata, kryesisht në dhomë këshillimi, verifikon mbi juridiksionin gjyqësor dhe

VEREN-se ;



Paditësi, Shoqëria K.F. "Vilaznia" sh.a., me administrator Astrit Gjyrezi, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkoder me kërkesë padi kundër palës së paditur Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, me objekt:

Shfuqizimin e plotë të raportit kontrollit perfundimtar të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkoder derguar me nr. 124/3 prot., date 13.12.2018 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder ndaj Njoftimit Vleresimi për detyrimet tatimore nr 124/4 prot., 07.12.2017.

*Rrethanat e çështjes;*

Palë paditëse është person juridik i së drejtës shqiptare me formë ligjore të organizimit të saj shoqëri aksionare. Subjekti është regjistruar në organet tatimore dhe është pajisur me NIPT LI7029001S, me administrator Astrit Gjyrezi.

Pranë këtij subjekti, sipas programit të kontrollit nr 124, dt 14.09.2017 është ushtruar kontroll me qëllimin saktësimin e rezultateve financiare, zbatimin e ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse për TVSH-në, saktësimin e llogaritës së detyrimeve për Sigurimet Shoqërore, shëndetësore dhe TAP.

Me shkresën nr. 124/3 Prot, date 13.12.2017, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër i ka derguar shoqërisë K.F. "Vilaznia" sh.a Raport-Kontrollin Perfundimtar, raport të cilit palë paditëse e ka gjykuar të padrejtë, duke e kundërshtuar me anë të Observacionit, protokolluar pranë (DRT) me nr. 124/2 Prot, date 16.11.2017. Palë e paditur pas observacionit të bërë nga palë paditëse ka njoftuar Shoqërinë K.F. "Vilaznia" sh.a., me "Njoftim Vleresimi për Detyrimet tatimore" nr 123/4 Prot, date 07.12.2017, ku Shoqëria K.F. "Vilaznia" sh.a., rezulton (për TVSH, tatim mbi të ardhurat, kontributet shoqërore), me detyrime +gjyba, në shumën totale 36.268.708 lekë.

Palë paditëse Shoqëria K.F. "Vilaznia" sh.a, duke mos qenë dakort me çfarë pretendohet nga ana e organit tatimor ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër "Njoftim Vleresimi për Detyrimet" nr. 123/4 Prot, date 07.12.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

Drejtorja e Apelit Tatimor përpara se të marrë në shqyrtim ankimin e tatimpaguesit në lidhje me ligjshmerinë dhe rregullshmerinë e akteve administrative të administratës tatimore paraprakisht vlereson plotësimin nga tatimpaguesi të kriterëve të percaktuara në nenet 106 dhe 107 të Ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH-se", konkretisht:

- *Tatimpaguesi nuk ka paguar apo nuk ka vendosur garanci bankare në lidhje me detyrimin e plotë tatimor të percaktuar në njoftim vleresimit e ankimit.*

Neni 107 i ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi shpreh:

*1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të percaktuar në njoftimin e vleresimit të administratës tatimore.*

2. Shuma e pagueshme ose shuma e vene si garanci bankare, sipas pikave 1 te ketij neni, perjashton gjokat e perfshira ne vleresimin tatimor te ankimuar.

3. Ankimi merret ne shqyrtim vetem kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, qe objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar qe verteton vendosjen e garancise, pas percaktimit te pikave 1 dhe 2 te ketij neni. (Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, date 28.12.2013. Nenetore Zyrtare Nr.203. date 30.12.2013)



Udhezimin nr. 24, date 02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", paragrafi 107.1

"Kur nje detyrim tatimor eshte objekt ankimi, ankimi pranohet vetem ne qofte se ankimuesi, neperputhje me nenin 107(1) te ligjit: paguan shumen e plote te detyrimit tatimor, objekt ankimi, te percaktuar ne aktin administrativ qe ankimohet ose vendos garanci bankare per keje shume;

verteton pagesen ose garancine, duke paraqitur nje kopje te dokumentit te pageses se detyrimit tatimor objekt ankimi ose te garancise bankare. Si vertetimi i pageses, dhe ai i garancise, jane kerkesa te detyrueshme"

Paragrafi 107.3.1 i Udhezimit nr. 24, date 02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" percakton se; "Neqofte se tatimpaguesi nuk paguan shumen e caktuar para skadimit te afatit te ankimit, ose nuk vendos garancine bankare. ankimi konsiderohet i papranueshem dhe refuzohet..."

Referuar dokumentacionit bashkelidhur kerkeses ankimore edhe pas kerkeses per plotesim te bere nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, tatimpaguesi nuk e ka plotesuar ketë detyrim ligjor, nuk ka paguar dhe nuk ka vendosur garanci bankare në lidhje me detyrimin tatimor të percaktuar në njoftim vleresimin e ankimuar brenda afatit të ankimit, dhe DPTatimore me vendimin e saj nr.7191/2 prot datë 13.04.2018, ka vendosur; *refuzimin e ankimit, ndaj Njoftim Vleresimit nr. 124/4 prot, datë 07.12.2017, nxjerrë nga DRT Shkodër, për shkak se nuk është plotësuar kushti ligjor për pagesën apo vendosjen e garancisë bankare për detyrimin e plotë të percaktuar në aktin administrativ të ankimuar.*

Drejtoria e Apelimit Tatimor duke refuzuar kerkesen ankimore të subjektit nuk ka shqyrtuar në thelb çështjen.

*Ne reference te nenit 107/4 te ligjit 9920 dt 19.05.2008 ku thuhet:*

*Akti administrative i leshuar nga administrata tatimore dhe per te cilin nuk eshte ankimuar ne rruge administrative, nuk mund te ankimohet ne rruge gjyqsore.*

Referuar sa me lart dhe objektit te kerkimit ne kerkese padi gjykata konstaton se padia nuk ploteson gjithashtu edhe kerkesat e nenit 16 te ligjit 49/2012 ku thuhet:

*Kushti për shterimin e ankimit administrative;*

1. Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ.

2. Përjashtohen nga ky rregull rastet kur:

a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë;

Pra pala paditëse nuk ka ezauruar rrugën administrative të shqyrtimit të çështjes mosmarrëveshja objekt gjykimi është jashtë juridiksionit gjyqësor .

Neni 9

*Kundërshtimi i juridiksionit;*

1. Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjyqimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent.

2. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji vendos në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve, nëse çështja përfshihet ose jo në juridiksionin gjyqësor.

Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin.

Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin.

3. Kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se çështja është brenda juridiksionit gjyqësor, prish vendimin dhe e dërgon çështjen për vazhdimin e gjyqimit me të njëjtin trup gjykues në gjykatën që kishte vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit.

Sa më lart, gjykata, konstaton se pala paditese nuk ka ezauruar ankimimin administrative ndaj aktit administrative njoftim vleresimin tatimor nr. 124/4 datë 07.12.2017, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, për pasojë konform nenit 9 të ligjit 49/2012, nxjerre çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, prandaj

### PER KETO ARSYE

Gjykata konform nenit 9, 16 të ligjit 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

### VENDOSI

Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor, të çështjes me nr.Rregj.Them. 558/1363 (31154-00423-83-2018) datë 17.05.2018, me palë paditese Shoqëria K.F. "Vllaznia" sh.a., me nipt LI7029001S, me Administrator z. Astrit Gjyrezi.

Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Për palët ndërgjyqëse, ky afat fillon nga dita e komunikimit të këtij vendimi.

Shkodër, datë 23.05.2019

SEKRETARE SEANCE

Borana LITI




PULLE TARIFE



GJYQITARE

Valbona BURRAJ



Shënim. Kundër vendimit Nr.304 (451) dt. 23.05.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka paraqitur ankim pala paditëse, Shoqëria K.F “Vllaznia” sh.a, për në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë Tiranë, me vendimin Nr. 00-2020-118 dt 15.06.2020 ka vendosur:

Prishjen e Vendimit Nr.304 (451) dt. 23.05.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate, me të njëjtin trup gjykues.

KANCILLARE

BLERTA NURIA







Republika e Shqiperise  
GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER

Nr. Prot: 333

Shkoder më: 24/03/2021

## V È R T E T I M

Vërtetohet se në Gjykatën Administrative të Shkalles se Pare Shkoder është në gjykim çështja civile me numër **31154-00486-83-2020** datë 08/07/2020 me objekt:

### Shfuqizim akti administrative

Shfuqizimin e plote te raport kontrollit perfundimtar te Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder derguar me nr.124/3 prot., date 13.12.2018 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder ndaj Njoftim Vleresimi per detyrimet tatimore nr124/4 prot.,07.12.2017

Palët:

Paditës : Shoqeria K.F.Vllaznia sh.a

I Paditur : Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder

Shënim: Vërtetimi pa pullë është i pavlefshëm



